



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 61

Prishtinë, më 6 prill 2010, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Qamile Morina, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja dhe Vezira Emrush.

Munguan: Teuta Hadri dhe Rita Hajzeraj.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore, Lulzim Çela - UNDP, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 23. 03. 2010,**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit të grevave para miratimit në parim,**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 23. 03. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Komisioni i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit të grevave para miratimit në parim

Sadik Idriz – E kemi marrë Projektligjin e grevave. Ky Projektligj nuk është shumë i madh, i ka vetëm disa nene dhe është i hartuar mirë, por problemi është se ky sikur edhe Projektligji i sindikatave, sipas strategjisë legislative është dashur të vinte bashkë me Ligjin e punës. Ligji i punës nuk ka ardhur në Kuvend, siç është paraparë në strategjinë legislative të Qeverisë. Në mbledhjen e radhës do ta ftojme ministrin e MPMS-së që të njoftohemi se ku ndodhet në procedurë Ligji i punës dhe ku janë pengesat që Ligji nuk ka ardhur në Kuvend. Mëdyshjet janë se a mund të miratohet dhe të hyjë në fuqi Ligji i grevave para Ligjit të punës, sepse këto dy ligje janë të ndërlidhura. Hap diskutimin.

Gjylnaze Sylja – Në vazhdimësi po ndodh që të na vijnë ligje të tjera dhe ende të mos na vijë Ligji bazik i punës. Edhe Ligji i grevave, edhe Ligji i punësimit të të huajve dhe Ligji i sindikatave, janë të lidhur ngushtë me miratimin e Ligjit të punës. Ligji është i hartuar mirë dhe është i qartë, por nuk mendoj se mund të zbatohet pa u miratuar Ligji i punës.

Flora Brovina – Ligji i grevave është ndalur edhe në mandatin e kaluar, sepse nuk mund të kemi Ligj të grevave pa Ligj të punës. Zyrtarisht duhet ta kemi një njoftim, pse në Kuvend nuk ka ardhur Ligji i punës, ashtu siç është paraparë në strategjinë legislative. Nuk mendoj që të miratohet Ligji i grevave pa miratimin e Ligjit të punës.

Nurishahe Hulaj – Edhe herën e kaluar është kthyer ky Ligj për shkak se nuk e kemi Ligjin e punës. Ky Ligj është i hartuar mirë, por nuk mund të gjejë zbatim pa miratimin e Ligjit të punës, prandaj nuk duhet të miratohet para tij.

Qamile Morina – Qeveria nuk po shikon se cilat ligje janë me prioritet, por po na vijnë ligjet, kështu, pa kurrfarë koordinimi. Ky Ligj në shumë nene, përveç që mbështetet në Ligjin e punës, mbështetet edhe në Kontratën kolektive, të cilën nuk e kemi. Ligji është i mirë, por nuk mund të zbatohet pa pasur Ligj të punës dhe Kontratë kolektive.

Pas diskutimeve anëtarët e Komisionit njëzëri u pajtuan t'i sugjerojnë Kuvendit që Ligji i grevave t'i kthehet Qeverisë derisa të miratohet Ligji i punës.

4. Të ndryshme

Sadik Idriz – Në këtë pikë i kemi disa çështje funksionale për t'i diskutuar. Çështja e parë është që listës së mëparshme të ekspertëve t'i shtohen edhe disa ekspertë, që janë të propozuar.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komisionit, u pajtuan që listës ekzistuese të ekspertëve t'i shtohen edhe ekspertët e propozuar.

Sadik Idriz – Çështje tjetër, që do ta diskutojmë në këtë pikë, është edhe ajo e projektligjeve, që i kemi në procedurë. Tri grupet e punës, të formuara për amendamentimin e ligjeve, që i kemi në procedurë, duhet ta vazhdojnë punën. Mendoj se Projektligji i Kryqit të Kuq dhe Projektligji i Emblemës së Kryqit të Kuq shumë shpejt do të përfundohen, ndërsa Ligji i produkteve dhe i pajisjeve medicinale kërkon punë më të madhe dhe më shumë kohë për t'u përfunduar.

Gjithashtu propozoj që anëtarë e grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Inspektoratit të Punës, në vend të Bujar Bukoshit të jetë Nurishahe Hulaj, ndërsa kryesuese të jetë Flora Brovina.

Sipas planit të punës dhe sipas propozimit të anëtarëve të Komisionit, të martën më 13 prill 2010, do ta ftojme të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit, ministrin e MPMS-së, Nenad Rashiq, i cili do ta njoftojë Komisionin se në ç'fazë të procedurës është Ligji i punës. Ministrit mund t'i shtrojmë pyetjet dhe mund të diskutojmë edhe për çështje tjera me interes për punën e kësaj Ministrie.

Gylnaze Syla – Me ministrin duhet t’i diskutojmë tri pika: e para, do të jetë legjislacioni, e dyta, puna e Ministrisë dhe e treta, prioritetet e kësaj Ministrie. Në bazë të prioritetëve, që i ka Ministria, mund ta mbajmë përgjegjës ministrin për realizimin e projekteve dhe të prioritetëve të parapara nga Ministria për vitin 2010.

Vezira Emrush – Duhet ta ftojë ministrin që të njoftojë për ligjet bazike, siç janë: Ligji i punës, Ligji i sigurimit pensional dhe invalidor, si dhe për Kontratën kolektive dhe ta miratojmë Ligjin e grevave. Tani duhet ta kthejmë Ligjin e grevave, deri sa të miratohet Ligji i punës.

Flora Brovina – Në takimin me ministrin duhet të diskutojmë edhe për dialogun social.

Sadik Idriz – Në takim me ministrin do t’i diskutojmë të gjitha temat, që u ngritën dhe do të njoftohemi për ligjet që janë në procedurë.

Pas diskutimeve anëtarët e Komisionit vendosën që më 13 prill 2010 ministri i MPMS-së, Nenad Rashiq, të ftohet në mbledhjen e Komisionit që ta informojë Komisionin për procedimin e ligjeve bazike, siç janë: Ligji i punës, Ligji i skemës sociale dhe Ligji i pensioneve. Gjithashtu ministri do t’i paraqesë para Komisionit planet dhe prioritetet e MPMS-së.

Sadik Idriz – Do të kemi edhe një takim me zyrtarë të UNDP-së dhe me ata të shoqatës „Friedrich Ebert Stiftung”, që ta shqyrtojmë mundësinë e organizimit të një vizite studimore në Slloveni lidhur me Ligjin e punës dhe me Ligjin e sigurimit shëndetësor.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 00

E përqatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz